

Të nderuar zonja dhe zotërinj, të dashur miq dhe bashkëpunëtorë,

Jam sinqerisht i nderuar dhe i lumtur që keni respektuar Bankën e Shqipërisë dhe stafin e saj me praninë tuaj në këtë sallë. Duke dashur të them pak fjalë dhe të shpreh shumë falenderim, do të përpiqem të mos zgjatem dhe të marr minutat e punës së kësaj Konference.

Miq të nderuar!

Banka e Shqipërisë, mjaft e re në moshën e saj ka tashmë një profil të thjeshtë, por krejtësisht të vetin, me të cilin ndoshta nuk mund të mburret, por mund të prezantohet si e barabartë midis homologeve të saja.

Në këta 10 vjet ajo ka mundur të zërë vendin që i takon në rradhën e institucioneve të respektuara financiare të vendit dhe sëbashku me to, të japë me përkushtim, ndihmesën e saj në krijimin e tablosë së re të financave dhe ekonomisë shqiptare.

Në këtë mënyrë është zhvilluar dhe, njëkohësisht, ka ndihmuar zhvillimin e ekonomisë së vendit duke përfituar dhe duke dhënë diçka nga vetja në çdo hap të hedhur.

Siç mund ta dimë të gjithë ne, kjo lloj marrëdhënieje që ka në bazën saj dëshirën e mirë dhe ndershmërinë reciproke të institucionit me qytetarët e vendit të tij, asnjëherë nuk është e thjeshtë. Ka koston e saj të zhvillimit, ka çmimin e saj të inteligjencës dhe të shpirtit, ka mbi të gjitha **vlerën** e besimit!

Banka e Shqipërisë i ka hedhur hapat e saj të ngadaltë, por të sigurt dhe në rrugën që ka zgjedhur të ndjekë është orientuar vazhdimisht drejt shembullit më të mirë, më të përparuar dhe më të sigurtë. I pari i ka shërbyer për të përfituar vëmendjen e institucioneve financiare ndërkombëtare; i dyti i ka dhënë të drejtën të synojë vazhdimisht për më shumë; i treti e ka bërë të jetë këmbëngulëse në atë që pretendon nga e ardhmja.

Duke dashur të mbetem besnik i premtimit tim të fillimit, për të mos marrë kohën e çmuar të të gjithëve ne, po përfundoj duke dashur të shpreh respektin tim për të gjithë ata që me punën e tyre modeste, kanë ndihmuar në krijimin e një brezi të bankierëve shqiptarë.

Të ftuar të nderuar të kësaj salle!

Kam një kënaqësi të veçantë dhe ndjehem i nderuar që të ftoj në foltore, Kryeministrin e Qeverisë Shqiptare z. Fatos Nano, i cili do të përshëndesë këtë Konferencë.

Duke uruar për një punë të mbarë dhe të vlefshme në këto dy ditë ju falenderoj edhe një herë që jeni të pranishëm.